


SHPENZIME PËR SHOQATAT QYTETARE NË BUXHETET E KOMUNAVE

Hulumtim për pagesat e bëra nga zëri buxhetor 463:
Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022

The background features a collage of financial-related images. On the left, a person's hands are seen working on a laptop. On the right, there are stacks of gold coins and a laptop. The top right corner displays a list of currency codes and their corresponding percentage changes: TVRZ (+0.75%), TAW (+0.75%), CAD (+0.49%), AEW (-0.34%), AS (-0.41%), and BAP (-0.30%).

SHPENZIME PËR SHOQATAT QYTETARE NË BUXHETET E KOMUNAVE

Hulumtim për pagesat e bëra nga zëri buxhetor 463
Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022

SHPENZIME PËR SHOQATAT QYTETARE NË BUXHETET E KOMUNAVE

Hulumtim për pagesat e bëra nga zëri buxhetor 463:
Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022

Botim elektronik:

(ТРОШКИ ЗА ЗДРУЖЕНИЈАТА НА ГРАЃАНИ ВО ОПШТИНСКИТЕ БУЏЕТИ –

Истражување за исплатите од буџетската ставка 463:

Трансферите до невладини организации во 2022 година

SHPENZIME PËR SHOQATAT QYTETARE NË BUXHETET E KOMUNAVE

Hulumtim për pagesat e bëra nga zëri buxhetor 463:

Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022)

Botues:

Qendra për Komunikime Qytetare

Përktheu nga gjuha maqedonase në gjuhën shqipe:

Agon Ismaili

Graphic design:

Relativ

Shkupi, nëntor 2023

CIP - Каталогизација во публикација

Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

352.073.52:061.2(497.7)"2022"(047.31)

ТРОШКИ за здруженијата на граѓани во општинските буџети [Електронски извор] : истражување за исплатите од буџетската ставка 463 : трансферите до невладини организации во 2022 година / [преведено од македонски на англиски јазик од преведувач Магдалена Симонска ; преведено од македонски на албански јазик од преведувач Агон Исмаили]. - Текст во пдф формат, содржи 37, 39, 39 стр. - Скопје : Центар за граѓански комуникаци ; Скопје : Center for civil communications ; Shkup : Qendra për komunikime qytetare, 2023

Начин на пристапување (URL):

<https://www.ccc.org.mk/images/stories/zdrmk.pdf>. - Напореден текст на мак., англ. и алб. јазик. - Наслов преземен од екран. - Опис на изворот на ден 24.11.2023 год. - Содржи и: Shpenzime për shoqatat qytetare në buxhetet e komunave hulumtim për pagesat e bëra nga zëri buxhetor 463 :

Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022 ; Trifles left for the citizens' associations in the municipal budgets research on payments from budget item 463 : transfers to non-governmental organizations for 2022. - Финансиер: Амбасадата на Кралството Холандија во Скопје, "Заштита од корупција" со финансиска помош

ISBN 978-608-4974-26-0

а) Локална самоуправа -- Буџет -- Трансфери -- Невладини организации -- Македонија -- 2022 -- Истражувања

COBISS.MK-ID 62489861



Kingdom of the Netherlands

Hulumtimi është përgatitur në kuadër të projektit "Mbrotje nga korrupsioni" me asistencë financiare nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup, ndërsa është zbatuar nga Qendra për Komunikime Qytetare, në periudhën nga 1 nëntor 2021 deri më 31 tetor 2024.




PËRMBAJTJA

- 6 Gjetjet kryesore
- 8 Synimi i hulumtimit
- 10 Hulumtim për pagesat nga zëri
buxhetor 463 - Transferet për organizatat
joqeveritare në vitin 2022
- 22 Mjetet e planifikuara në zërin
buxhetor 463 për vitin 2023
- 23 Hulumtim në nivel të komunave
- 36 Rekomandime

GJETJET KRYESORE

- Shoqatat qytetare dhe fondacionet nuk e fitojnë mbështetjen e nevojshme financiare nga buxhetet e komunave. Në vitin 2022, mesatarja e mjeteve që komunat i kanë ndarë nga buxhetet e tyre për shoqatat qytetare është vetëm 0.1%.
- Mbi 90% e mjeteve nga zëri buxhetor 463 i titulluar Transfere për organizatat joqeveritare u janë paguar klubeve sportive. Të preferuarit e autoriteteve lokale janë klubet profesionale sportive, të cilat në disa komuna kanë fituar edhe nga 1 milion euro në nivel vjetor.
- Me pagesën e mjeteve ndaj klubeve sportive nëpërmjet zërit buxhetor 463 – Transferet për organizatat joqeveritare krijohet një imazh i shtrembëruar se mbështetja për shoqatat qytetare në nivel lokal është më e lartë nga niveli i vërtetë.
- Vlera mesatare e mjeteve që u është paguar shoqatave qytetare është modeste edhe atë 75 mijë denarë (1,227 euro), ndërsa për klubeve sportive, mesatarisht nga 488 mijë denarë (7,930 euro).
- Pjesa më e madhe e mjeteve të cilat u janë paguar vetëm shoqatave qytetare dhe fondacioneve janë për projekte nga sfera e mbrojtjes sociale, pas këtyre vijojnë projekte në sferën e kulturës dhe mjedisit jetësor. Thua se nuk ka projekte në sferën e qeverisjes së mirë, gjë që e pamundëson për shoqatat qytetare të japin kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve lokale.
- Hulumtimi e vërteton qasjen e ndryshme të komunave gjatë shpërndarjes së mjeteve për shoqatat qytetare. Gjendja e këtillë krijon rrezik nga korrupsioni.
- Thirrjet publike për shpërndarje të mjeteve për mbështetje financiare për shoqatat qytetare publikohen në ueb-faqet e komunave, por më së shpeshti, në to nuk janë cekur synimet e thirrjes, vlera e granteve e as kriteret për përzgjedhje të propozim-projekteve. Në të shumtën e rasteve, në thirrjet janë cekur fushat për të cilat ndahen mjete dhe kushtet të cilat shoqatat qytetare duhet t'i plotësojnë. Në këtë mënyrë, krijohet mundësi për trajtim të pabarabartë të shoqatave të qytetarëve dhe favorizim të disa shoqatave qytetare të caktuara.

- Thirrjet për shpërndarje të mjeteve për mbështetje financiare për klubet sportive te shumica e komunave përmbajnë informacione vetëm në lidhje me atë se kush mund të aplikojë, por jo edhe me synimet për mbështetjen ose kriteret për përzgjedhjen. Në këtë mënyrë rriten mundësitë për ndikime subjektive.
- Thujse është përjashtim, e jo rregull që thirrjet për shpërndarje të ndihmës financiare të mos ndërlidhen me programe dhe strategji konkrete të komunave.
- Madje, është evidentuar një rast me një komunë e cila ka shpallur thirrje publike për shpërndarje të mjeteve, ka sjell vendim për përzgjedhjen e projekteve, mirëpo pagesa e mjeteve asnjëherë nuk është realizuar.
- Lista e organizatave të cilat kanë fituar mbështetje financiare nga komunat, shuma e mjeteve të fituara dhe dedikimi i tyre nuk janë publike te pjesa më e madhe e komunave. Kjo jo-transparencë i zmadhon rreziqet nga korrupsioni.
- Për nivelin e ulët të llogaridhënies së komunave në lidhje me mënyrën se si shoqatave qytetare dhe klubeve sportive u shpërndahen mjetet, flasin edhe të dhënat që te shumica e komunave, madje edhe në listat për grantet e ndara (të fituara përmes kërkesave për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik), mungojnë titujt e projekteve që financohen. Mungesa e llogaridhënies krijon mundësi për shpenzim të paligjshëm dhe pa dedikim të mjeteve të transferuara si dhe cenim të reputacionit të secilit prej përfituesve të mbështetjes financiare përkatësisht të çdo shoqate qytetare dhe klub sportiv.
- Pjesa më e madhe e komunave, nuk kërkojnë raporte për realizimin e projekteve nga pranuesit e mjeteve. Si rrjedhojë e kësaj, mungon edhe publikim i raporteve për realizimin e projekteve të financuara nga zëri buxhetor 463. Në këtë mënyrë, krijohet hapësirë për keqpërdorime dhe pamundësohet këqyrje në mënyrën e shpenzimit të mjeteve buxhetore që shpie edhe në dyshime për arsyeshmërinë e shpenzimeve buxhetore.



SYNIM I HULUMTIMIT

Ky hulumtim ka për qëllim t'i hartëzojë karakteristikat e procesit të financimit të organizatave joqeveritare nga zëri buxhetor 463, të konstatohet niveli i transparencës dhe llogaridhënies së komunave, të identifikohen problemet dhe mangësitë në proces, si dhe të përkufizohen rekomandime për përmirësimin e praktikave tanimë të vendosura.

Të udhëhequr nga ideja që përfaqësimi për mbështetje financiare më transparente dhe më efikase të organizatave joqeveritare nga ana e komunave do të ketë efikasitet më të lartë nëse është i bazuar në paraqitje të detajuar të gjendjes aktuale, këtë analizë e kemi bazuar mbi përpunimin e të dhënave në lidhje me të gjitha mjetet financiare të paguara nga njësitë e vetëqeverisjes lokale për financimin e organizatave joqeveritare si dhe me mënyrën në të cilën është zbatuar procesi nga ana e secilës komunë veçmas (Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip), mjetet e të cilave janë paguar nëpërmjet zërit buxhetor 463 dhe paraqesin një të tretën e totalit të mjeteve paguara nga ana e të gjitha komunave në vend.

Mbështetja financiare e komunave për shoqatat qytetare në nivel lokal është në veçanti e rëndësishme dhe mbijetesa dhe veprimi i tyre në pjesë të madhe varen pikërisht nga këto mjete. Lëndë e këtij hulumtimi janë vlera dhe mënyra e shpërndarjes së mjeteve nga zëri buxhetor. Shpesh, pjesë e këtyre organizatave lokale, përkrah vizionit dhe misionit të qartë të tyre, shuhen për shkak të shpërndarjes joadekuate të këtyre mjeteve për shoqatat, veprimi i të cilave nuk mund të vlerësohet se mbulon interes më të gjerë të qytetarëve.

Metodologjia e hulumtimit rezultoi nga synimet e vendosura. Për sigurimin e të dhënave të nevojshme, më 20 shkurt 2023, në 8 komuna janë dërguar kërkesa të unifikuara për qasje tek informacionet me karakter publik për mjetet financiare të cilat u janë paguar OJQ-ve për vitin 2023 (transferet për organizatat joqeveritare nga zëri buxhetor 463), me kërkesën që t'i dërgojnë dokumentet si më poshtë:

- Shumat e mjeteve të parapara për zërin buxhetor 463, të zbërthyera në llogari me gjashtë shifra, në Buxhetin fillestar për vitin 2022 dhe shumat e mjeteve të realizuara për vitin 2022 të zbërthyera në llogari me gjashtë shifra;
- Listë e organizatave përfituese të mbështetjes financiare nga zëri buxhetor 463 për vitin 2022, me titujt e projekteve për të cilët është shpërndarë mbështetja financiare, si dhe shuma konkrete e cila u është paguar;
- Thirrja e shpallur për dorëzimin e aplikacioneve dhe informacion ku e kanë publikuar thirrjen;

- Dokumenti në të cilin janë shpjeguar procedura, kriteret dhe mënyra e përzgjedhjes së organizatave të cilave u janë paguar mjete financiare dhe informacion ku është publikuar dokumenti;
- Vendimi për shpërndarjen e mjeteve financiare nga zëri buxhetor 463 për vitin 2022;
- Dokumenti me rregullat për realizimin e mjeteve të paguara – detyrimi për dorëzim të raporteve për realizimin (raport narrativ dhe financiar);
- Një link ose më tepër, të ueb-faqes ose vend tjetër ku janë publikuar organizatat të cilat kanë fituar mjete si dhe shuma e mjeteve financiare që u është paguar atyre për vitin 2022;
- Dokumente ose link elektronik ku organizatat japin llogari për projektet e realizuara me mjetet financiare të cilat u janë paguar nga komuna;
- Mjete të planifikuara për zërin buxhetor 463, të zbërthyer në llogari me gjashtë shifra në Buxhetin për vitin 2023.

Në bazë të informacioneve të fituara, për vërtetësinë e të cilave përgjegjësia u përket komunave, krahas kësaj analize mbi mënyrën e pagesës së mjeteve nga zëri buxhetor 463, është përgatitur edhe një bazë e të dhënave të hapura me prezantim të mjeteve financiare të paguara nga ana e tetë komunave në Republikën e Maqedonisë për vitin 2022 (emrat e OJQ-ve, titulli i projektit dhe shuma e paguar për mbështetje financiare).

Në kuadër të këtij hulumtimi, gjithashtu janë paraqitur rekomandime për përmirësimin e mënyrës së financimit të organizatave joqeveritare si dhe për rritjen e transparencës dhe llogaridhënies gjatë procesit.

Ky hulumtim i Qendrës për Komunikime Qytetare është realizuar në suaza të Projektit “Mbrotjtje nga korrupsioni” i financuar nga Ambasada e Mbretërisë së Holandës në Shkup.

HULUMTIM MBI PAGESAT NGA ZËRI BUXHETOR 463 - TRANSFERET PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE NË VITIN 2022

Duke u nisur nga qëndrimi se organizatat joqeveritare luajnë rol të rëndësishëm për zhvillimin lokal dhe se nga aktiviteti i tyre gjerësisht varet suksesi për artikullimin e interesave të qytetarëve në të gjitha segmentet e jetës shoqërore, lëndë e këtij hulumtimi është vëllimi i mbështetjes financiare të cilën e fitojnë organizatat joqeveritare nga njësitë e vetëqeverisjes lokale si dhe transparenca dhe ligjshmëria në tërë këtë procesi.

Hulumtimi është fokusuar mbi shpenzimet nga zëri buxhetor 463 – “Transferet për organizatat joqeveritare” dhe nuk i përfshin pagesat të cilat komunat i kanë bërë ndaj OJQ-ve në bazë të marrëveshjeve të lidhura për bashkëpunim si rezultat i kompetencave të transferuara të komunës ndaj personave të tjerë juridikë (joprofitabil ose profitabil) në fushat siç janë arsimiti, kultura, mbrojtja sociale etj.

Zëri buxhetor 463 me titullin “Transferet për organizatat joqeveritare” i përfshin zërat si më poshtë:

- 463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet
- 463120 Transferet për klubet sportive
- 463130 Transferet për Komitetin Olimpik të Maqedonisë
- 463140 Transferet për organizatat të cilat kujdesen për persona të moshuar dhe persona me hendikep
- 463150 Transferet për bashkësitë lokale
- 463160 Transferet për organizatat humanitare
- 463170 Transferet për partitë politike
- 463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare.

Pothuaj të gjitha komunat kur i publikojnë shpenzimet që i kanë bërë, në llogaritë përfundimtare të buxheteve, e bëjnë publike shumën totale të transfereve që i kanë paguar për organizatat joqeveritare kurse nuk janë paraqitur shumat e nënpërmbledhjeve veçmas. Në këtë mënyrë, pamundësohet këqyrje e qartë sa prej parave janë ndarë për financimin e aktiviteteve të shoqatave qytetare dhe fondacioneve, e sa për klubet sportive, bashkësitë lokale etj. Për ndërtimin e një shoqërie qytetare të fortë e të pavarur, me rëndësi thelbësore është fakti nëse mbështetja është mundësuar në procedurë transparente ose lihet

hapësirë për favorizimin e aktiviteteve të cilat në vend të interesit publik i mbrojnë interesat e ngushtë partiakë të autoriteteve lokale.

Në vitin 2022, nga 81 njësi të vetëqeverisjes lokale, 74 kanë bërë pagesa nëpërmjet zërit buxhetor 463 – Transferet për organizatat joqeveritare. Shuma e përgjithshme që e kanë paguar nga ky pozicion buxhetor është 406 milionë denarë ose 6,6 milionë euro. Për këtë dedikim, shpenzimet vjetore që i kanë bërë komunat kanë lëvizur prej 1,2 milionë euro deri në vetëm 488 euro. Në llogaritë përfundimtare të komunave nuk është prezantuar (llogari me gjastë shifra) sa nga këto para u janë paguar shoqatave qytetare, e sa klubeve sportive.

Mbi 90% të komunave në vitin 2022 kanë pasur shpenzime nga zëri buxhetor 463 – Transferet për organizatat joqeveritare edhe atë në shumën prej 74 milionë denarë (1,2 milion euro) deri 30 mijë denarë (488 euro).

Gjatë kësaj, shuma totale të cilën e kanë paguar të gjitha 74 njësitë e vetëqeverisjes lokale nga zëri buxhetor 463 – Transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2022 është 406 milionë denarë përkatësisht 6,6 milionë euro, që paraqet 1.02% nga buxhetet e përgjithshme të njësive të vetëqeverisjes lokale.

Në vendin e parë, për nga shuma e parave të shpenzuara për transfere për organizatat joqeveritare është Komuna e Manastirit e cila nga ky pozicion buxhetor ka paguar shumën prej 74 milionë denarë (1,2 milion euro) që paraqet 18.2% të pagesave totale nga zëri buxhetor 463 nga ana e të gjitha njësive të vetëqeverisjes lokale.

Dhjetë komunat të cilat i kanë bërë pagesat më të larta nga zëri buxhetor 463 për vitin 2022 kanë transferuar 73.8% të totalit të mjeteve që janë paguar nga ky pozicion buxhetor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Dhjetë komunat me pagesën më të lartë nga zëri buxhetor 463

Komuna	Mjete të realizuara - 463 në vitin 2022 në denarë	Mjete të realizuara - 463 në vitin 2022 në euro
Manastir	74,137,943	1,205,495
Qyteti i Shkupit	55,526,065	902,863
Aerodrom	38,650,000	628,455
Ohër	28,186,490	458,317
Kavadarci	26,869,627	436,905
Kumanovë	20,000,000	325,203
Qendër	16,450,000	267,480
Shtip	15,284,505	248,529
Strumicë	14,126,431	229,698
Gazi Babë	10,921,100	177,579

Sa i përket pjesëmarrjes së mjeteve të realizuara nga zëri buxhetor 463 në raport me buxhetet e përgjithshme të komunave, Manastiri është sërish në pozitën e parë me pothuaj 4%, para komunave Aerodrom, Makedonska Kamenica dhe Novaci.

Dhjetë komunat me pjesëmarrjen më të lartë në zërin buxhetor 463 në buxhetin e përgjithshëm

	Komuna	Përqindje e pjesëmarrjes së zërit 463 në buxhetin total
1	Manastir	3.99%
2	Aerodrom	3.45%
3	Makedonska Kamenica	2.77%
4	Novaci	2.68%
5	Kavadari	2.48%
6	Ohër	2.42%
7	Gjevgjeli	2.09%
8	Qendër	1.77%
9	Shtip	1.61%
10	Radovish	1.46%

Shumat më të vogla të pagesave nga ky pozicion buxhetor i kanë bërë komunat Zelenikovë dhe Zërnovci, prej 30 mijë denarë (488 euro), ndërsa komunat Haraçinë, Pllasnicë, Zhelinë, Llozovë, Rankovcë, Qendra Zhupë dhe Çuçer Sandevë nuk kanë bërë pagesa.

Dhjetë komunat me pagesat më të vogla nga zëri buxhetor 463

Komuna	Mjete të realizuara - 463 në vitin 2022 në denarë	Mjete të realizuara - 463 në vitin 2022 në euro
Bërvenicë	175,000	2,846
Vevçani	170,000	8,764
Krivogashani	151,500	2,463
Makedonski Brod	135,000	2,195
Staro Nagoriçani	120,000	1,951
Jegunovcë	43,500	707
Tetovë	40,000	650
Pehçevë	35,000	569
Zërnovci	30,000	488
Zelenikovë	30,000	488

Hulumtimi i thellë, zbulon që mbi 90% të parave nga zëri buxhetor 463 i titulluar - Transferet për organizatat joqeveritare u janë paguar klubeve sportive. Të preferuarit e autoriteteve lokale janë klubet lokale sportive, që në disa komuna të caktuara madje kanë fituar mjete financiare deri 1 milion euro në vit. Duke e pasur parasysh që mbështetja për shoqatat qytetare dhe klubet sportive realizohet nga zëri i njëjtit buxhetor, krijohet ide e shtrembëruar se mbështetja për shoqatat qytetare në nivel lokal është më e madhe nga niveli i vërtetë.

Që të mund të futemi më në thellësi lidhur me mënyrën se si ndahen mjetet nga zëri buxhetor 463 – Transferet për organizatat joqeveritare, analiza e më tutjeshme është e fokusuar në tetë komuna, edhe atë: Manastir, Kërçovë, Kumanovë, Negotinë, Strumicë, Tetovë, Çair dhe Shtip. Për relevancën e dokumentit në të cilin do të figurojnë të dhënat, më së miri flet fakti që pikërisht nëpërmjet këtyre komunave janë paguar një e treta e totalit të parave nga zëri buxhetor 463. Përkatësisht, në pajtim me të dhënat nga llogaritë përfundimtare të tetë komunave, ato kanë paguar gjithsej 135 milionë denarë apo 2,2 milionë euro, që donë të thotë se janë realizuar 97% nga mjetet fillimisht të planifikuara në shumë prej 139 milionë denarë (2,2 milionë euro). Të gjitha tetë komunat kanë pasur gjithsej 414 transfere nga zëri buxhetor 463, me të cilat janë mbështetur shoqata të qytetarëve, klube sportive, organizata komunale ose manifestime të caktuara. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, në vendin e parë në listë, sipas vlerës së pagesave nga zëri buxhetor 463 është komuna e Manastirit me 74 milionë denarë (1,2 milion euro) ndërsa në vendin e fundit është komuna e Tetovës, me vetëm 40 mijë denarë (650 euro).

Rang listë sipas vlerës së pagesave nga zëri buxhetor 463 në vitin 2022

Komuna	Shuma e mjeteve të realizuara në denarë nga llogaria përfundimtare	Shuma e mjeteve të realizuara në denarë nga përgjigjet e fituara
Manastir	74,137,943	73,907,000
Kumanovë	20,000,000	20,000,000
Shtip	15,284,505	15,284,500
Strumicë	14,126,431	14,126,431
Negotinë	4,404,500	4,404,500
Çair	4,143,000	4,143,000
Kërçovë	2,760,000	2,760,000
Tetovë	40,000	40,000

Sipas pjesëmarrjes në zërin buxhetor 463 në raport me buxhetin e përgjithshëm, Komuna e Manastirit është në vendin e parë në listë me 4%.

Pjesëmarrje e pagesave nga zëri 463 në buxhetin e përgjithshëm të komunave

	Komuna	Pjesëmarrja me përqindje
1	Manastir	3.99%
2	Shtip	1.61%
3	Negotinë	1.18%
4	Strumicë	1.16%
5	Kumanovë	1.08%
6	Çair	0.49%
7	Kërçovë	0.34%
8	Tetovë	0.003%

Analiza e transfereve financiare për organizatat joqeveritare sipas llogarive tregon që sporti është bindshëm në vendin më të lartë. Madje 91.2% të parave nga pozicioni 463120, të dedikuara për transferet për organizatat joqeveritare ose gjithsej 123 milionë denarë përkatësisht 2 milionë euro u janë transferuar klubeve sportive.

Shoqatave qytetare, përkatësisht nga zëri buxhetor 463110 (transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet) 8 komunitat u kanë transferuar 10,7 milionë denarë, përkatësisht 173 mijë euro apo vetëm 8.1%. Organizatave humanitare, nga zëri buxhetor 463160 (transferet për organizatat humanitare), nga këto tetë komuna, vetëm Komuna e Strumicës ka transferuar 265 mijë denarë (4,3 mijë euro) dhe përmes zërit buxhetor 463190 – (transfere tjera për organizatat joqeveritare) janë transferuar gjithsej 675 mijë denarë (11 mijë euro) nga Komuna e Strumicës dhe Komuna Çair.


Lartësia e shumës së mjeteve të paguara nga zëri buxhetor 463 –
Transferet për organizatat joqeveritare, në tetë komunitat

Llogaria	Mjete të paguara (denarë)*	Mjete të paguara (euro)
463110 Transferet për shoqatat e qytetarëve dhe fondacionet	10,660,981	173,349
463120 Transferet për klubet sportive	123,144,500	2,002,350
463160 Transferet për organizatat humanitare	265,000	4,309
463190 Transferet tjera për organizata joqeveritare	674,950	10,975

*burimi i të dhënave – përgjigje në kërkesat për qasje lirë tek informacionet me karakter publik

Siç mund të shihet nga prezantimi grafik, pjesëmarrja e klubeve sportive është 91.2%, ndërsa e shoqatave qytetare 8.1%, e transfereve për organizatat humanitare vetëm 0.2% dhe e transfereve tjera 0.5%.

STRUKTURA E MJETEVE TË PAGUARA NGA ZËRI BUXHETOR 463 – TRANSFERET PËR ORGANIZATAT JOQEVERITARE



Pjesa më e madhe e parave nga buxhetet e komunave përfundojnë në klubet profesionale të cilat garojnë në ligat e rangut më të lartë në sportet përkatëse, ndërsa vetëm një pjesë e vogël përfundon për sportin rekreativ dhe atë shkollor. Në vendin e parë, për nga madhësia e mbështetjes së fituar janë klubi i basketbollit, futbollit dhe hendbollit "Pelister" Manastir, që kanë fituar 1 milion euro në vitin 2022.

Sipas të dhënave të fituara nga komunat, mjetet prej 123 milionë denarë apo 2 milionë euro u janë ndarë klubeve të sporteve të ndryshme të cilat garojnë në nivele të ndryshme. Ndër to, ka edhe klube të cilat janë të regjistruara si Shoqëri Aksionare sikur KF "Pelister" - ShA Manastir, KB "Pelister" ShA dhe KH "Eurofarm Pelister" ShA, klube tjera profesionale sikur KF "Bregallnica" – Shtip dhe KF "Akademia Pandev".

Ndërmjet klubeve sportive të financuara nga tetë komunat të cilat janë lëndë e analizës, më së shumti mjete kanë fituar KB "Pelister" ShA - 26,1 milionë denarë (424 mijë euro), para KF "Pelister" ShA - 19,4 milionë denarë (315 mijë euro), KH "Eurofarm Pelister" ShA - 15,8 milionë denarë (257 mijë euro) dhe KSB "Pelister" - 3,8 milionë denarë (62 mijë euro) nga komuna e Manastirit, KF "Bregallnica" - 9 milionë denarë (146 mijë euro) nga komuna Shtip dhe KF "Akademia Pandev" - 2,5 milionë denarë (41 mijë euro) nga komuna e Strumicës. Së këtejmi, rezulton që madje më tepër se gjysma e mjeteve të dedikuara për financimin e organizatave joqeveritare nga tetë komunat e analizuar janë shpenzuar në këto gjashtë klube sportive.

Komuna e Kumanovës 18 milionë denarë (293 mijë euro) të dedikuara për klube sportive ia ka transferuar Lidhjes së sporteve, e cila më vonë i ka shpërndarë mjetet ndaj klubeve veçmas. Sipas komunës, ajo nuk i ka të dhënat për atë se cilave klube u janë shpërndarë këto mjete, por në analizë janë marrë parasysh të dhënat nga Programi për zhvillimin e sportit dhe aktiviteteve rekreative të qytetarëve në Komunën e Kumanovës për vitin 2022.

Komuna e Manastirit i ka bërë tre pagesat më të mëdha ndaj klubeve sportive ndërmjet tetë komunave të cilat janë lëndë e hulumtimit.

Klubet sportive me pagesat më të larta nga zëri 463120

	Komuna	Klubi	Shuma në denarë
1	Manastir	KB "Pelister" ShA	26,100,000
2	Manastir	KF "Pelister" Manastir ShA	19,350,000
3	Manastir	KH "Eurofarm Pelister" ShA	15,800,000
4	Shtip	KF "Bregallnica"	9,000,000
5	Kumanovë	ShVP KB "Kumanovë 2009"	5,000,000
6	Manastir	KSB "Pelister"	3,800,000
7	Strumicë	KF "Akademia Pandev"	2,500,000
8	Negotinë	KH "Vardar" Negotinë	2,000,000
9	Kumanovë	Sport shkollor	1,700,000
10	Kumanovë	Lidhja komunale e sporteve Kumanovë – bazat e programës	1,550,000
11	Kumanovë	KHF "Kumanovë"	1,500,000
12	Strumicë	KF "Bellasica"	1,500,000
13	Kumanovë	Përkrahje për sigurim të transportit, akomodimit, ushqimit, terreneve të sportit dhe objekte për realizimin e procesit të stërvitjeve dhe ndeshjeve të kampionatit për klubet sportive dhe lidhjet e sportit	1,400,000
14	Strumicë	KV "Strumica 47 72"	1,300,000
15	Çair	KB "Çair 2030"	1,200,000

Vështruar në nivel të shoqatave të qytetarëve, mbështetja financiare është disa herë më e vogël. Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor i radhës, në vendin e parë për nga vlera është mbështetja që është ndarë nga Komuna e Kumanovës për Shoqatën – Qendra Rajonale për persona me pengesa intelektuale "Poraka-Nasha" në shumë prej 1,2 milionë denarë (19,5 mijë euro). E radhës, për nga lartësia është mbështetja për Rrjetin nacional për luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – "Zë kundër dhunës", që është dhënë nga ana e komunës së Manastirit në shumë prej 1 milion denarë (16 mijë euro).

Shoqata të qytetarëve me pagesat më të larta nga zëri 463110

	Komuna	Organizata	Projekti	Fusha	Shuma në denarë
1	Kumanovë	Shoqatë rajonale – Qendra për persona me pengesë intelektuale “Poraka Nasha”	Për funksionim të organizatës	Mbrojtja sociale	1,200,000
2	Manastir	Rrjeti nacional për luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje – “Zë kundër dhunës”	Për funksionim të organizatës	Mbrojtja sociale	1,000,000
3	Kumanovë	Shoqata për promovim dhe zhvillim të shoqërisë inkluzive “Inkluziva”	Për funksionim të organizatës	Mbrojtja sociale	800,000
4	Shtip	Shoqata humanitare “Podaj raka, spasi zhvot”	Rojtarë të mjedisit jetësor	Mjedisi jetësor	299,955
5	Shtip	Shoqata për aktivitete humanitare “Sinergija” Shtip	Të rinjtë nëpërmjet start-up biznesit kreatorë të zhvillimit lokal ekonomik	Të rinjtë	299,250
6	Shtip	Shoqata e gjahtarëve “Llovec”	Fëmijët si promotorë ekonomik dhe turistik të komunës dhe rojtarë të ekosistemit	Të rinjtë	299,250
7	Strumicë	ShQ Shoqëria ekologjike bjeshkatere “Edellvajs”	Fizibiliteti studim për vetë-qëndrueshmëri energjetike të stacioneve për ujëra të zeza	Mjedisi jetësor	237,500
8	Strumicë	Shoqatë për kulturë dhe zhvillim të industrive kreative “Kult-Tranzen”	Filmofilë	Kultura	237,500
9	Strumicë	ShQ për socializim “Tregime të lumtura”	Strumica Eko grafite	Kultura	237,500
10	Strumicë	Shoqata Rome-Turke “Hajat” - OJQ	Ëndrrat tuaja tani janë reale – Ide të reja projekte të reja	Të rinjtë	237,500
11	Strumicë	ShQ “Poraka” Shoqata CPLIP “Poraka” – Strumicë	Personat me pengesa, pjesëmarrës të barabartë në komunikacion	Mbrojtja sociale	237,500
12	Strumicë	ShQ “KVO Vadis” ShA Astra	Udhëtojmë nëpër Itali	Tjera	237,309
13	Strumicë	Shoqata për zhvillim dhe edukim të personave me pengesa në zhvillim “Ednakvost”	Barazi për të gjithë	Mbrojtja sociale	236,075
14	Strumicë	Shoqata për avancim dhe zhvillim të bujqësisë “Proagro fermerë”	Bukuritë e fshatit	Zhvillim lokal ekonomik	235,932
15	Strumicë	Shoqata për zhvillim të bujqësisë “Fermer”	Start ap rural	Zhvillim lokal ekonomik	228,000

Pjesa më e madhe e parave në zërin buxhetor 463110 – Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet, edhe atë 43% janë ndarë për projekte nga fusha e mbrojtjes sociale në shumë prej 4,6 milionë denarë përkatësisht rreth 75 mijë euro. Në vendin e dytë me pjesëmarrje prej 17% janë projektet nga fusha e kulturës për të cilat janë ndarë gjithsej 1,8 milionë denarë përkatësisht rreth 30 mijë euro. Në vendin e tretë është fusha e mjedisit jetësor me pjesëmarrje prej 13% dhe vlerë prej 22 mijë euro. Pjesa tjetër e mjeteve janë për projekte të cilat janë të dedikuara për zhvillimin lokal ekonomik, për financim të manifestimeve të ndryshme ose nga përshkrimi i vet projektit nuk mund të konstatohet fusha e veprimit. Thuajse nuk ka projekte nga fusha e qeverisjes së mirë me çka pamundësohet që shoqatat qytetare të japin kontribut në luftën kundër korrupsionit dhe në rritjen e transparencës dhe llogaridhënies së autoriteteve lokale.

Madje 70% prej granteve të ndara për shoqatat qytetare arrijnë vlerën deri 60 mijë denarë (976 euro). Vlera mesatare e mjeteve të ndara për shoqatat qytetare është 75 mijë denarë (1,227 euro), ndërsa për klubet e sportit, mesatarisht janë transferuar nga 488 mijë denarë (7,930 euro). Gjatë kësaj, mbështetja financiare për shoqatat qytetare lëviz nga shuma modeste prej 5 mijë denarë (81 euro) deri 1,2 milion denarë (19,5 mijë euro).

Sipas bazës me të dhënat, komunat kanë mbështetur 257 klube sportive dhe 157 organizata joqeveritare. Mund të konstatohet që shuma mesatare e paguar ndaj klubeve sportive është 487,702 denarë ose 7,930 euro ndërsa shuma mesatare e paguar ndaj shoqatave qytetare është gjashtëfish më e vogël edhe atë 75,500 denarë përkatësisht 1,227 euro.

Shuma më e lartë e paguar ndaj një shoqate qytetare është shuma e mbështetjes financiare e komunës së Kumanovës për Shoqatën – Qendra rajonale për persona me pengesë intelektuale “Poraka-Nasha” në shumë prej 1,2 milion denarë që është 18 herë më pak nga shuma më e lartë e paguar ndaj klubeve sportive, të cilën e ka fituar KB Pelister ShA në vlerë prej 26,1 milionë denarë.

Në prezantimin tabelor të radhës, janë paraqitur shumat më të larta dhe më të ulëta të paguara në nivel të këtyre tetë komunave. Rezulton se është rregull i pashkruar, që shumat më të larta të paguhen ndaj klubeve sportive, ndërsa më të voglat ndaj shoqatave qytetare.

Rezulton që madje 70% të granteve të ndara për shoqatat qytetare janë në suazat e vlerës prej 5 mijë deri 60 mijë denarë.

Raporti i shumës më të lartë dhe shumës më të ulët të paguar në secilën nga komunat

Komunë	Shuma më e lartë	Shuma në denarë	Shuma më e ulët	Shuma në denarë
Manastir	KB "Pelister" ShA	26,100,000	5 organizata	5,000
Kërçovë	4 klube sportive	300,000	4 klube sportive	20,000
Kumanovë	ShVS KB "Kumanovë 2009"	5,000,000	7 klube sportive	20,000
Negotinë	KH "Vardar" Negotinë	2,000,000	2 organizata	10,000
Strumicë	KF "Akademia Pandev"	2,500,000	2 klube sportive	30,000
Тетово	ShQ "Sharr"	40,000	ShQ Sharr	40,000
Shtip	KF "Bregallnica"	9,000,000	2 organizata	5,000
Çair	KB "Çair 2030"	1,200,000	ShKA Ljiljan	15,000

Thirrjet publike për ndarje të mjeteve shpallen, mirëpo më së shpeshti vetëm formalisht, për shkak se në to nuk janë të cekur synimet e thirrjes, rezultatet e pritura, vlera e granteve e as kriteret për përzgjedhjen e propozim-projekteve. Në thirrjet, më së shpeshti janë paraqitur fushat për të cilat ndahen mjete si dhe kushtet të cilat shoqatat qytetare duhet t'i plotësojnë.

Me qëllim që të vërtetohet niveli i transparencës dhe llogaridhënies së komunave në ndarjen e mjeteve nga zëri buxhetor 463, nga komunat, kemi kërkuar dokumente lidhur me thirrjen e shpallur publike për ndarje të mjeteve; lidhur me procedurën, kriteret për evaluim dhe mënyrën e përzgjedhjes së fituesve të mjeteve; për vendimin e miratuar për shpërndarje të mjeteve financiare; rregullat për realizimin e mbështetjes së fituar (detyrimi për paraqitje të raporteve për realizimin – raport narativ dhe financiar); për publikimin e emrave të OJQ-ve dhe shumën e parave e cila u është ndarë atyre si dhe dokumente ose link elektronik për raportin/ dhe për projektet e realizuara. Në bazë të dokumentacionit të fituar, është përgatitur prezantim i nivelit të transparencës së komunave në lidhje me të gjitha fazat e financimit nga zëri buxhetor 463.

Këqyrja në këto procedura, në pjesën e mëtejme të analizës, është bërë pikërisht sipas radhës kronologjike të procedurave, duke filluar nga thirrja publike e deri në çështjen nëse shoqatat qytetare kanë për detyrë të përpilojnë raporte për atë që e kanë realizuar.

Inkurajon fakti që secila nga tetë komunat të cilat janë subjekte të hulumtimit kanë shpallur thirrje për të aplikuar për projekte, mirëpo thirrjet nuk i përmbajnë të gjitha të dhënat që janë në interes të aplikantëve potencial dhe të cilët ofrojnë transparencë të plotë të procesit të aplikimit dhe ndarjes së mjeteve.

Në thirrjet publike, më së shpeshti janë cekur fushat për të cilat ndahen mjetet dhe kushtet që duhet t'i plotësojnë shoqatat qytetare, por mungojnë synimet e thirrjes, rezultatet e pritura, vlera e granteve, ndërsa te disa prej tyre edhe kriteret për përzgjedhje të propozim-projekteve.

Në vetëm dy prej gjithsej 15 thirrjeve të shpallura për ndarje të mjeteve nga zëri buxhetor 463 janë cekur synimet e thirrjes, ndërsa në të gjitha thirrjet tjera janë cekur vetëm fushat.

Në asnjë nga thirrjet për parashtrim të propozim-projekteve për financim nuk janë cekur rezultatet e pritura që duhet të përmbushen me mbështetjen.

Ndërkaq, vetëm në një të tretën e thirrjeve është cekur shuma totale e mjeteve ose vlera e granteve të cilat do të ndahen.

Në të njëjtën kohë, vetëm në një të tretën e thirrjeve për ndarje të mjeteve janë cekur kriteret për përzgjedhje të propozim-projekteve.

Nga tetë komunitat, gjashtë kanë paraparë procedura dhe kriteret për përzgjedhje të organizatave dhe projekteve për ndarje të mjeteve nga zëri buxhetor 463. Kriteret më së shpeshti janë pjesë e metodologjive të posaçme ose të rregulloreve dhe në të shumtën e rasteve ato nuk janë cekur në thirrjet publike.

Kriteret në bazë të cilave bëhet përzgjedhja e që janë paraparë në metodologjitë dhe rregulloret e komunave kanë të bëjnë me kapacitetin organizativ, synimet, rezultatet dhe aktivitetet e projektit, efektet në mjedisin lokal, buxhetin e paraparë dhe arsyeshmërinë e shpenzimeve. Njëra nga komunitat formon edhe Komisionin i cili del në terren me qëllimin për të kryer këqyrje.

Dy komunitat tjera në këtë pyetje kanë dhënë përgjigje negative ose në dokumentacionin e fituar prej tyre, lidhur me kërkesën për qasje tek informacionet me karakter publik, nuk është përfshirë dokument në të cilin janë paraqitur kriteret në bazë të cilëve bëhet përzgjedhja e organizatave të cilat do të fitojnë mbështetjen.

Lista e organizatave të cilat kanë fituar mbështetje nga komunitat, shuma e mjeteve të fituara dhe dedikimi i atyre mjeteve nuk janë të dhëna publike të pjesa më e madhe e komunave të cilat kanë pasur transfere nga zëri buxhetor 463. Jotransparenca e këtillë i zmadhon rreziqet nga korrupsioni dhe shpenzimi pa dedikim.

Të gjitha tetë komunitat qëndrojnë mirë në lidhje me procedurën juridike për ndarjen e mjeteve financiare, duke e pasur parasysh faktin që secila prej tyre ka vendim për transferet. Megjithatë, vetëm dy prej tyre e kanë bërë publike listën me emrat e organizatave të cilat kanë fituar mbështetje me projektet dhe shumat e paguara. Gjatë kësaj, edhe ato kanë shpallur lista që nuk janë të plota, përkatësisht i kanë paraqitur emrat dhe shumën e mbështetjes për shoqatat qytetare, mirëpo publikisht nuk janë shpallur klubet sportive të cilat janë të mbështetur financiarisht. Sa i përket mungesës së llogaridhënies së komunave, në lidhje me mënyrën e ndarjes së mjeteve nga zëri buxhetor "Transferet për organizatat joqeveritare" më së miri flet fakti që madje edhe në listat për grantet e ndara, të cilat i kemi fituar nëpërmjet kërkesave për qasje tek informacionet me karakter publik mungojnë titujt e projekteve që janë të financuar.

Pjesa dërmuese e komunave, nga përfituesit e mjeteve, nuk kërkojnë raporte për realizimin e projekteve. Si rrjedhojë e kësaj, mungon edhe publikimi i raporteve për realizimin e projekteve të financuar nga zëri buxhetor 463. Në këtë mënyrë, pamundësohet këqyrje mbi mënyrën dhe synimin e shpenzimit të mjeteve buxhetore dhe krijohet hapësirë për keqpërdorime si dhe rriten dyshimet në arsyeshmërinë e shpenzimeve buxhetore.

Një nga instrumentet më të rëndësishme për të monitoruar nëse paratë e qytetarëve shpenzohen me dedikim dhe nëse në fund ka pasur rezultate nga aktivitetet që janë ndërmarrë në ndonjë fushë të caktuar janë raportet nga përfituesit e mjeteve, si financiare ashtu edhe ato narrative.

Sipas përgjigjeve të fituara nga komunat, asnjëra komunë nuk kërkon nga klubet sportive të parashtrojnë raporte për realizimin e projekteve (narrative dhe financiare), ndërsa nga shoqatat qytetare, ky detyrim është vërejtur vetëm te gjysma e komunave.

Një rrezik shtesë nga shpenzimi pa dedikim dhe i paligjshëm i mjeteve të ndara rezulton edhe nga mungesa e praktikës që vet komunat të informojnë për rezultatet e përmbushura me projektet e financuara si dhe për mënyrën në të cilën janë shpenzuar këto mjete financiare.

Veprimi i këtillë i komunave krijon pasqyrë negative për shoqatat qytetare dhe nuk kontribuon për përforcimin e besimit të qytetarëve në to.

MJETET E PLANIFIKUARA PËR ZËRIN BUXHETOR 463 PËR VITIN 2023

Në vitin 2023, secila nga tetë komunat e ka zvogëluar shumën e paraparë për transferet për organizatat joqeveritare për 22,554,012 denarë (367 mijë euro) përkatësisht për 26.6%. Zvogëlime kanë bërë komunat Manastir dhe komuna e Kumanovës, komunat Çair dhe komuna Negotinë kanë paraparë shuma identike për të dy vitet, ndërsa komuna e Strumicës, komuna e Shtipit, komuna e Kumanovës dhe komuna e Kërçovës e kanë zmadhuar shumën e paraparë të transfereve për organizatat joqeveritare në vitin 2023.

Komuna	Shumë e mjeteve të planifikuara në denarë (2022)	Shumë e mjeteve të planifikuara në denarë (2023)	Zmadhim/zvogëlim i mjeteve të planifikuara në vitin 2023
Manastir	74,268,000	41,450,000	-32,818,000
Kumanovë	20,000,000	19,500,000	-500,000
Shtip	15,650,000	15,750,000	+100,000
Strumicë	15,086,012	17,850,000	+2,763,988
Tetovo	1,660,000	2,460,000	+800,000
Kërçovë	6,740,000	7,840,000	+1,100,000
Çair	2,000,000	2,000,000	0
Negotinë	500,000	500,000	0

Sa u përket llogarive veçmas, përsëri më së shumti mjete janë paraparë për zërin buxhetor 463120 - Transferet për klubet sportive.

Mjete të parapara për zërin buxhetor 463 sipas llogarive me gjashtë shifra

	463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	463120 Transferet për klubet sportive	463160 Transferet për organizatat humanitare	463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare
Manastir	1,850,000	39,600,000	0	0
Kërçovë	3,480,000	4,000,000	0	360,000
Kumanovë	3,000,000	16,500,000	0	0
Negotinë	380,000	/	20,000	100,000
Strumicë	3,000,000	12,250,000	300,000	2,300,000
Tetovo	2,000,000	150,000	120,000	190,000
Shtip	2,150,000	13,600,000	0	0
Çair	1,300,000	300,000	200,000	200,000
Gjithsej	17,160,000	86,400,000	640,000	3,150,000

Prezantime më të detajuara të mjeteve të planifikuara nga zëri buxhetor 463 për vitin 2023 janë paraqitur në hulumtimet konkrete mbi komunat.

HULUMTIM NË NIVEL TË KOMUNAVE

KOMUNA E MANASTIRIT

Komuna e Manastirit është në vendin e parë në listën për mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 për vitin 2022 me mjete të realizuara në shumë prej 74 milionë denarë përkatësisht 1,2 milion euro që paraqet 4% të buxhetit total të komunës për vitin 2022.

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 nga Komuna e Manastirit në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	3,107,000
463120 Transferet për klubet sportive	70,880,000
Gjithsej në denarë	73,907,000
Gjithsej në euro	1,201,740

Megjithatë pjesa më e madhe e mjeteve të paguara përkatësisht 88% u janë paguar katër klubeve profesionale sportive edhe atë 26,1 milionë denarë (424 mijë euro) për KB "Pelister" ShA, 19,5 milionë denarë (315 mijë euro) për KF "Pelister" ShA 15,8 milionë denarë (257 mijë euro), për KH "Eurofarm" dhe 3,8 milionë denarë (62 mijë euro) për KSB "Pelister". Sa u përket shoqatave qytetare, mbështetjen më të madhe e ka fituar organizata Rrjeti nacional për luftë kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës familjare, për aktivitete në kuadër të projektit "Zë kundër dhunës" në shumë prej 1 milion denarë (16 mijë euro).

Sa i përket procedurës për ndarje të mjeteve, Komuna e Manastirit ka shpallur katër thirrje të cilat kanë të bëjnë me përkrahje të projekteve për mbrojtjen sociale, mundësitë e barabarta, shoqatat sportive dhe mbështetje financiare për shoqatat qytetare dhe fondacionet.

Të gjitha thirrjet janë publikuar në ueb-faqen e komunës, si dhe në tabelën e shpalljeve të komunës.

Analiza e thirrjeve të publikuara sugjeron në moskonzistencë ndërmjet tyre. Në thirrjen për ndarje të mjeteve financiare për shoqatat qytetare dhe fondacionet janë cekur buxheti i përgjithshëm i cili do të shpërndahet në suazat e thirrjes, kriteret në bazë të cilave do të bëhet vlerësimi i cilësisë së projekteve të shoqatave qytetare dhe fondacioneve, korniza kohore për zbatimin e projekteve, shuma e mjeteve financiare për projekt konkret dhe dokumentacioni i nevojshëm për t'u paraqitur.

Struktura e Thirrjeve për përkrahje të projekteve nga sfera e mbrojtjes sociale dhe e mundësive të barabarta është e ngjashme, por në to nuk është cekur buxheti i përgjithshëm e as shuma e mjeteve financiare për një projekt të caktuar.

Në këto tre thirrje është cekur se mënyra e shfrytëzimit të mjeteve financiare do të jetë e përcaktuar në mënyrë plotësuese në marrëveshjet e lidhura.

Thirrja për ndarje të mjeteve financiare për klubet sportive, shoqatat sportive dhe sportistët i përmban kushtet dhe dokumentacionin e duhur për t'u paraqitur, vlerën e buxhetit të paraparë dhe detyrimin për raport, mirëpo jo edhe kriteret në bazë të cilave do të bëhet përzgjedhja e as shuma e mjeteve financiare me të cilat do të përkrahen aplikimet konkrete.

Të gjitha thirrjet, përveç asaj për mbështetje të sportit, përmbajnë kritere konkrete në bazë të cilëve bëhet evaluimi i propozim-projekteve.

Kriteret në bazë të cilëve bëhet vlerësim i cilësisë së projekteve të shoqatave dhe fondacioneve janë kapaciteti organizativ në lidhje me profilin, kapacitetin dhe përvojën përkatëse nga sfera e përgjegjësisë shoqërore, synimet, rezultatet dhe aktivitetet e projektit, efektet mbi mjedisin lokal, buxheti dhe arsyeshmëria e shpenzimeve.

Komuna ka përpiluar Metodologji për përcaktimin e kriterëve për ndarje të mbështetjes financiare për shoqatat qytetare dhe fondacionet, e cila është e publikuar në gazetë zyrtare dhe në ueb faqe të komunës.

Me metodologjinë, komuna i përcakton sferat prioritare për mbështetje, gjatë vendimmarrjes, përgatitjes teknike, kornizën kohore indikative, kriteret për aplikim, kriteret për vlerësimin e cilësisë së aplikantëve që janë të cekur edhe në tre nga katër thirrjet, si dhe kriteret për zbatim të projekteve të mbështetura dhe monitorimin e zbatimit të tyre.

Komuna e Manastirit i ka dërguar vendimet me të cilat ndahen mjetet financiare, por lista e përfituesve nuk bëhet publike.

Në lidhje me raportimin për mjetet e paguara, komuna thotë që ekziston detyrim për paraqitjen e raporteve, mirëpo përfituesit e mbështetjes janë të detyruar që ato t'i dorëzojnë gjatë vitit të ardhshëm kur të aplikojnë dhe kjo lë hapësirë që ndonjë raport të mos parashtrohet nëse ndonjë organizatë nuk aplikon për mbështetje vitin e ardhshëm.

Komuna e Manastirit konsiderueshëm i ka zvogëluar mjetet e planifikuara për transferet për organizatat joqeveritare në vitin 2023 në raport me vitin paraprak. Në vitin 2023, nga buxheti i saj, komuna do të ndajë 32,8 milionë denarë (533 mijë euro) më pak që paraqet zvogëlim për 44% në raport me vitin e mëparshëm. Komuna përfaqëson i ka përgjysmuar mjetet për transferet edhe për shoqatat edhe për klubet sportive.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Manastirit në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	1,850,000	-40.46%
463120 Transferet për klubet sportive	39,600,000	-44.14%
Gjithsej në denarë	41,450,000	-43.92%
Gjithsej në euro	673,984	-43.92%

KOMUNA E KËRÇOVËS

Komuna e Kërçovës nga zëri buxhetor 463, për vitin 2022 ka paguar gjithsej afro 2,8 milionë denarë përkatësisht 45 mijë euro. Mjetet e paguara janë konsiderueshëm nën shumën e mjeteve të planifikuara e cila ka qenë 6,7 milionë denarë (110 mijë euro).

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës së Kërçovës në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	350,000
463120 Transferet për klubet sportive	2,410,000
Gjithsej në denarë	2,760,000
Gjithsej në euro	44,878

Madje 87% të pagesave të Komunës së Kërçovës janë bërë ndaj klubeve sportive, ndër të cilat, pagesat më të larta janë për Klubin e Volejbollit "Uskana" dhe klubet futbollistike "Zajazi" dhe "Napredok 1", edhe atë nga 300 mijë denarë (rreth 5 mijë euro).

Përveç klubeve sportive, mbështetje financiare në vitin 2022 u është dhënë Shoqatës "Go-li" me shumë prej 180 mijë denarë përkatësisht rreth 3 mijë euro dhe Shoqatës së të rinjve për mbrojtjen e trashëgimisë popullore dhe shpirtërore "Kozma Preçistanski" 140 mijë denarë (2,2 mijë euro).

Komuna e Kërçovës ka shpallur thirrje për mbështetje të shoqatave sportive, mirëpo nuk është publikuar shpallje për ndarje të mjeteve për programet tjera. Së këtejmi, parashtrohet pyetja si është bërë përzgjedhja e dy shoqatave qytetare të cilat kanë fituar mbështetje nga buxheti i komunës. Mungesa e transparencës në procesin e ndarjes së mjeteve shpie në trajtim të pabarabartë të shoqatave qytetare dhe tendencë subjektive në ndarjen e financave publike.

Përndryshe, thirrja e publikuar për mbështetje të shoqatave sportive dhe të ekipeve i përmban synimet e thirrjes, buxhetin e përgjithshëm, vlerën e granteve dhe kriteret për pjesëmarrje, por jo edhe kriteret në bazë të cilëve do të bëhet përzgjedhja e aplikimeve që do të mbështeten.

Komuna ka miratuar Propozim-program për aktivitetet e komunës në sferën e sportit dhe rekreacionit në vitin 2022, në të cilin, si kriteret për përzgjedhje janë cekur efekti i qëllimit të përgjithshëm të projektit në afirmimin e sportit, struktura organizative dhe kapaciteti i resurseve njerëzore dhe nëse hapësirat që i ka në dispozicion shoqata ose klubi janë të mjaftueshme për realizimin e projektit.

Në thirrjen për mbështetje të shoqatave sportive dhe ekipeve, shkruan që edhe pas përfundimit të aktiviteteve, shoqatat dhe klubet detyrohen të parashtrojnë raport për mënyrën e realizimit të mjeteve, ndërsa dokumentacioni i përgjithshëm për këtë thirrje dorëzohet në formë të printuar në adresën e komunës. Në thirrjen, gjithashtu shkruan që përfutjesit e mjeteve do të publikohen në ueb-faqen e komunës, megjithatë nuk janë publikuar, përveç në Gazetën Zyrtare të Komunës.

Në përgjigjen për Kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, ka një link për në ueb faqen e Komunës së Kërçovës dhe është shënuar se të gjitha informacionet publikohen në tabelën e shpalljeve të ueb-faqes, mirëpo pas kërkimit në të, **nuk mund të gjendet informacion për organizatat dhe mjetet e ndara.**

Për vitin 2023, Komuna e Kërçovës në zërin buxhetor 463 ka planifikuar 7,8 milionë denarë (127 mijë euro) që paraqet rritje për 14% në raport me mjetet e planifikuara për vitin 2022.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Kërçovës në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	3,480,000	+1.75%
463120 Transferet për klubet sportive	4,000,000	+35%
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	360,000	+45.45%
Gjithsej në denarë	7,840,000	+14%
Gjithsej në euro	127,480	+14%

KOMUNA E KUMANOVËS

Komuna e Kumanovës është një nga komunat e cilat i ka paguar të gjitha mjetet nga zëri buxhetor 463 në vitin 2022, në shumë prej 20 milionë denarë (325 mijë euro).

Siç mund të shihet nga prezantimi tabelor, 90% e mjeteve janë ndarë për sport edhe me ndërmjetësim të Lidhjes komunale të sporteve Kumanovë, e cila i ndan mjetet në emër të komunës në pajtim me Rregulloren për mënyrën e ndarjes së mjeteve për realizimin e Programit për zhvillim të sportit dhe për aktivitete rekreative të qytetarëve në Komunën e Kumanovës për vitin 2022.

Sipas përgjigjes nga komuna, Lidhja komunale i njofton anëtarët e saj nëpërmjet telefonit ose postës-elektronike për dërgim të programit për aktivitete dhe financa të klubeve. **Krahas insistimeve që nga komuna të na e dërgojnë listën e klubeve që janë të financuar nga zëri buxhetor 463 si dhe shumat që janë ndarë, të dhënat e tilla nuk i fituam dhe na kanë udhëzuar të drejtohem i Lidhja komunale e sporteve – Kumanovë si bartës i informacioneve. Kjo qasje e komunës nuk është në favor të rritjes së transparencës në shpenzimin e financave publike.** Përndryshe, sipas programit për zhvillim të sportit dhe aktiviteteve rekreative të qytetarëve të Komunës së Kumanovës për vitin 2022, mjetet më të mëdha janë paraparë për klubin e basketbollit “Kumanovo 2009”, edhe atë në shumë prej 5 milionë denarë (81 mijë euro).

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës e Kumanovës në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	2,000,000
463120 Transferet për klubet sportive	18,000,000
Gjithsej në denarë	20,000,000
Gjithsej në euro	325,203

Komuna e Kumanovës ka shpallur thirrje publike për mbështetje financiare, gjatë kryerjes së punëve në mbrojtjen sociale nga shoqatat dhe persona të tjerë juridikë të cilët realizojnë aktivitetet me fokus mbi personat me pengesa. Në thirrjen janë cekur synimet e thirrjes, buxheti total dhe kushtet për t’u paraqitur. Kriteret për përzgjedhje janë të rregulluar me Rregulloren për mënyrën dhe procedurën për realizimin e të drejtës për mbështetjes financiare për kryerjen e punëve në fushën e mbrojtjes sociale nga shoqatat dhe persona të tjerë juridikë të cilët realizojnë aktivitetet me fokus mbi personat me pengesa. Rregullorja parasheh që kërkesat të shqyrtohen nga Komisioni i formuar me aktvendim të Kryetarit të komunës. Komisioni del në teren dhe kryen këqyrje, për çka përpilon procesverbal nga këqyrja e kryer, ndërsa pastaj edhe raport në të cilin e konstaton përmbushjen e kriterëve. Kryetari i komunës, sipas raportit të Komisionit propozon vendim për shpërndarje të mjeteve financiare për kryerjen e punëve në fushën e mbrojtjes sociale nga shoqatat dhe persona të tjerë juridikë të cilët realizojnë aktivitetet me fokus mbi personat me pengesa, të cilin e miraton Këshilli i komunës.

Dy organizatat e vetme nga Komuna e Kumanovës të cilat kanë fituar mbështetje financiare sipas kësaj thirrjeje janë Shoqata – Qendra Rajonale për persona me pengesa intelektuale “Poraka Nasha” në shumë prej 1,2 milionë denarë (19,5 mijë euro) dhe Shoqatat për promovim të shoqërisë inkluzive “Inkluziva” në shumë prej 800 mijë denarë (13 mijë euro). Në përgjigjen lidhur me kërkesën për qasje tek informacionet me karakter publik, komuna e ka cekur se në pajtim me marrëveshjet të cilat i ka lidhur me të dy shoqatat,

ato parashihet që në bazë mujore të parashtrojnë raporte narrative dhe financiare si dhe një raport final pas përfundimit të vitit rrjedhës 2022, mirëpo ato raporte nuk janë bërë publike.

Në lidhje me mjetet e planifikuara për zërin buxhetor 463 për vitin 2023, Komuna e Kumanovës ka paraparë gjithsej 19,5 milionë denarë (317 mijë euro) që paraqet zvogëlim për 2.5% në raport me vitin paraprak. Mirëpo, është e rëndësishme gjatë kësaj, të theksohet se është projektuar që transferet ndaj shoqatave qytetare dhe fondacioneve të zmadhohen për 50%, ndërsa transferet për klubet sportive të zvogëlohen për 8.3 %.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Kumanovës në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	3,000,000	+50%
463120 Transferet për klubet sportive	16,500,000	-9%
Gjithsej në denarë	19,500,000	-2.5%
Gjithsej në euro	317,073	-2.5%

KOMUNA NEGOTINË

Komuna Negotinë ka paguar gjithsej 4,4 milionë denarë përkatësisht rreth 72 mijë euro, mirëpo vetëm 7.8% prej tyre u janë paguar organizatave joqeveritare, ndërsa të tjerat, klubeve sportive.

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës e Negotinës në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	345,000
463120 Transferet për klubet sportive	4,059,500
Gjithsej në denarë	4,404,500
Gjithsej në euro	71,618

Komuna Negotinë në ueb faqen e saj ka shpallur një thirrje për ndarje të mjeteve financiare për shoqata dhe fondacione për vitin 2022, në të cilën krahas sferave tjera është përfshirë edhe sporti. Thirrja i përmban shumën e mjeteve, kriteret për t'u paraqitur si dhe kriteret në bazë të cilëve do të bëhet evaluimi i paraqitjeve, por jo edhe synimet e thirrjes (çka dëshiron komuna të arrijë përkatësisht të realizojë me ndarjen e mbështetjes financiare), ndërsa është një shënim i cili thotë se vlera e granteve është e pakufizuar, që nuk ka logjikë.

Komuna ka Rregullore për përcaktimin e procedurës dhe kriteret për ndarje të ndihmës financiare për shoqatat dhe fondacionet nga buxheti i komunës Negotinë. Me rregulloren përcaktohen sferat prioritare për përkrahje, procedura për miratim të vendimeve për financim të projekteve të shoqatave dhe fondacioneve, përgatitja për shpallje, korniza indikative kohore, kriteret për të aplikuar, për zbatimin e projekteve të mbështetura dhe monitorim të zbatimit të projekteve të përkrahura.

Kriteret në bazë të cilëve bëhet vlerësim i cilësisë së projekteve për shoqatat dhe fondacionet, ndërsa të cilët janë cekur edhe në thirrjen publike edhe në rregulloren, janë kapaciteti organizativ, lidhja e projektit me sferën prioritare, synimet, rezultatet, aktivitetet dhe qasja e projektit, efektet mbi mjedisin lokal, buxheti dhe arsyeshmëria e shpenzimeve. Gjatë kësaj, në situatat kur nuk janë përcaktuar qartë synimet e mbështetjes, evaluimi nuk mund të bazohet në parametra konkret e të matshëm.

Komuna ka transparencë selektive dhe në ueb faqen e saj e ka publikuar vendimin me përfituesit e mbështetjes financiare, por vetëm deri në shumën prej 200 mijë denarë (3,2 mijë euro) përkatësisht lista nuk i përfshin klubet sportive që kanë fituar mbi 90% të mjeteve financiare.

Të dhënat për klubet sportive fillimisht nuk janë as në përgjigjen për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik dhe ato i kemi siguruar përmes komunikimit shtesë me komunën.

Sipas këtyre të dhënave, shuma më e lartë i është paguar KH Vardar Negotinë në shumë prej 2 milionë denarë (32 mijë euro). Në lidhje me organizatat të cilat veprojnë në sfera tjera, shumat më të larta i kanë fituar shoqatat "Poraka" dhe "Ekovita".

Në përgjigjen e saj, komuna Negotinë e ka cekur se organizatat të cilat kanë qenë financiarisht të mbështetura, e kanë për detyrë të parashtojnë raport deri më 30 qershor vitin e ardhshëm.

Edhe në vitin 2023, komuna Negotinë ka paraparë gjysmë milion denari për organizatat joqeveritare. Maksimalisht, nga 380 mijë denarë (6,2 mijë euro) janë planifikuar për shoqatat qytetare dhe fondacionet, nga 20 mijë denarë (325 euro) për organizatat humanitare dhe 100 mijë denarë (1,625 euro) për transfere tjera. Është me rëndësi të përmendet që në këto përlllogaritje mungojnë të dhënat për zërin buxhetor 463120 - Transferet për klubet sportive.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Negotinës në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	380,000	0%
463160 Transferet për organizatat humanitare	20,000	0%
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	100,000	0%
Gjithsej në denarë	500,000	0%
Gjithsej në euro	8,130	0%

KOMUNA E STRUMICËS

Komuna e Strumicës ka paguar më tepër se 14 milionë denarë, përkatësisht rreth 230 mijë euro, mirëpo, madje 79% u janë ndarë klubeve sportive.

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës e Strumicës në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	2,236,481
463120 Transferet për klubet sportive	11,100,000
463160 Transferet për organizatat humanitare	265,000
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	524,950
Gjithsej në denarë	14,126,431
Gjithsej në euro	229,698

Komuna e Strumicës ka shpallur katër thirrje të cilat janë të dedikuara për shoqata qytetare dhe fondacione nga sfera e mbrojtjes sociale, pastaj për zhvillimin lokal ekonomik, turizmin, mbrojtjen e mjedisit jetësor, kulturën, arsimin, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe të rinjtë, gjithashtu për persona juridikë nga sfera e sportit dhe për përkrahje të trajnerëve në shoqatat sportive.

Thirrja për fondacionet nga sfera e mbrojtjes sociale, si dhe ajo që është në lidhje me zhvillimin lokal ekonomik, turizmin, mbrojtjen e mjedisit jetësor, kulturën, arsimin, barazinë gjinore, të drejtat e njeriut dhe rininë për nga struktura janë identike. Në to janë cekur lënda e thirrjes publike, e drejta e pjesëmarrjes, vlera e projekteve që do të financohen, kriteret për pjesëmarrje dhe kohëzgjatja e realizimit, por asnjë nga thirrjet nuk parasheh kriteret në bazë të cilëve do të bëhet përzgjedhja e propozim-projekteve. **Komuna ka përpiluar dokument me rregullat për përgatitje dhe aplikim, i cili përmban rregulla, mirëpo jo edhe kriteret në bazë të cilëve do të bëhet përzgjedhja ose vlerësimi përkatës me pikë. Në këtë mënyrë rritet rreziku nga subjektiviteti në përzgjedhje dhe lihet mundësi për trajtim të pabarabartë.**

Thirrjet për persona juridikë nga sfera e sportit dhe për përkrahje të trajnerëve në shoqatat e sportit nuk përmbajnë asgjë më tepër nga kriteret themelore dhe mënyrën e aplikimit. Komuna ka përpiluar Metodologji për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e mjeteve financiare për shoqatat sportive dhe personat e tjerë juridikë në sferën e sportit dhe Metodologji për përcaktimin e kriterëve për shpërndarjen e mjeteve financiare për trajnerë në klubet e sportit.

Metodologjia e përmban procedurën për shpalljen e thirrjes publike, procedurën gjatë vendimmarrjes për shpërndarjen e mjeteve, vendimin për shpërndarjen e mjeteve, sistemin e vlerësimit me pikë, procedurën e lidhjes së marrëveshjeve dhe raportin për realizimin.

Shuma më e lartë të cilën komuna e Strumicës e ka paguar nga zëri buxhetor 463 i është paguar KF "Akademia Pandev" në shumë prej 2,5 milionë denarë (rreth 41 mijë euro). Nga organizatat të cilat nuk veprojnë në sport, shuma më e lartë i është ndarë Shoqatës qytetare Shoqëria Ekologjike Bjeshkatore "Edellvajs", edhe atë 237,5 mijë denarë (rreth 4 mijë euro).

Në ueb faqen e komunës së Strumicës nuk janë publikuar organizatat të cilat kanë fituar mjete nga buxheti i komunës. Në përgjigjen për kërkesën për qasje tek informacionet me karakter publik, komuna thotë që

organizatat e përkrahura rregullisht dorëzojnë raporte narrative dhe financiare të cilët janë të regjistruar në arkivin e komunës, mirëpo publiku nuk ka qasje tek ato. Gjithashtu e cekin se për projektet e realizuara, shoqatat raportojnë në mediat sociale.

Në lidhje me mjetet e planifikuara në zërin buxhetor 463 për vitin 2023, komuna e Strumicës ka paraparë gjithsej 17,85 milionë denarë (290 mijë euro) që paraqet rritje për 15% në raport me vitin 2022. Sipas të dhënave të fituara nga komuna e Strumicës, nuk është e mundur të bëhet krahasim i ndryshimit në mjetet e parapara në secilin prej zërave buxhetorë mes viteve 2022 dhe 2023.

Projektime të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Strumicës në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	3,000,000
463120 Transferet për klubet sportive	12,250,000
463160 Transferet për organizatat humanitare	300,000
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	2,300,000
Gjithsej në denarë	17,850,000
Gjithsej në euro	290,243

KOMUNA E TETOVËS

Komuna e Tetovës ka sjell vendim për shpërndarje të mbështetjes financiare për 34 organizata në vlerë totale prej pothuaj 3,5 milionë denarë përkatësisht 57 mijë euro, por është paguar vetëm një grant në vlerë prej vetëm 40 mijë denarë përkatësisht 650 euro. Gjatë kësaj, organizata e vetme (Shoqata “Sharr”) e cila ka fituar përkrahje nga zëri buxhetor 463, nuk ka qenë në listën e projekteve të miratuara.

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës e Tetovës në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	40,000
Gjithsej në denarë	40,000
Gjithsej në euro	650

Më 30.12.2021, komuna e Tetovës ka shpallur thirrje për financim të projekteve nga sfera e kulturës, arsimit, sportit dhe mbrojtjes sociale. Krahas sferave për financim, thirrja përmban të dhëna për mënyrën e aplikimit, mirëpo nuk përmban të dhëna për synimin e thirrjes, buxhetin e paraparë, kriteret për pjesëmarrje, kriteret në bazë të cilëve do të bëhet përzgjedhja, vlerën e granteve konkrete e as rregulla për raportim në lidhje me atë që është realizuar.

Në shtojcë të përgjigjes në kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, komuna ka dërguar listë të 34 organizatave për të cilat shumat e mjeteve që janë shpërndarë kanë lëvizur prej 15 mijë deri 330 mijë denarë, ose në total 4,825,980 denarë (78 mijë euro) në vitin 2022. Pas konstatimit që në llogarinë përfundimtare për vitin 2022, si mjete të realizuara nga zëri buxhetor 463 figurojnë vetëm 40 mijë denarë (650 euro), në mënyrë plotësuese e kontaktuam komunën duke kërkuar sqarimin për mospërputhjen mes të dhënave, për çka na është dhënë përgjigja se mjetet nga lista e dërguar në të vërtetë nuk janë të paguara dhe se vetëm 40 mijë denarë i janë paguar Shoqatës “Sharr”, e cila as nuk figuron në listën e dërguar.

Për vitin 2023, komuna ka paraparë mjete në shumë prej 2,46 milionë denarë që paraqet rritje për 48% e cila nuk do të ketë fare rëndësi, në qoftë se, sikur edhe këtë vit, pjesa më e madhe e mjeteve financiare të planifikuara ngelin të papaguara.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Tetovës në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	2,000,000	+40%
463120 Transferet për klubet sportive	150,000	0%
463160 Transferet për organizatat humanitare	120,000	0%
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	190,000	0%
Gjithsej në denarë	2,460,000	+32.5%
Gjithsej në euro	40,000	+32.5%

KOMUNA ÇAIR

Komuna e Çairit ka paguar 4,14 milionë denarë (67 mijë euro) nga të cilat, thuhet se 70% u janë paguar klubeve sportive. Në përgjigjen e parë për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, komuna e Çairit nuk i ka dorëzuar të dhënat që kanë të bëjnë me pagesat ndaj klubeve sportive të cilat janë siguruar pas komunikimit shtesë..

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës e Çairit në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	1,143,000
463160 Transferet për klubet sportive	2,850,000
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	150,000
Gjithsej në denarë	4,143,000
Gjithsej në euro	67,366

Komuna e Çairit ka shpallur thirrje për grumbullimin e kërkesave për shfrytëzim të mjeteve nga buxheti i komunës së Çairit për vitin 2022 nga Programi për zhvillimin dhe avancimin e sportit dhe aktiviteteve sportive-rekreative. Thirrja i përmban kriteret themelore për pjesëmarrje dhe mënyrën për t'u paraqitur, ndërsa nuk ka të dhëna për shumën e mjeteve të cilat do të shpërndahen me thirrjen, vlerën e granteve ndaras si dhe për evaluimin e paraqitjeve.

Siç është cekur në përgjigjen për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, komuna ende nuk e ka miratuar rregulloren për procedurën, kriteret dhe mënyrën e përzgjedhjes së organizatave. Krahas kësaj, komuna ka vendim me të cilin i ka shpërndarë mjetet, mirëpo ngelet pyetja sipas cilëve kriterë.

Shuma më e madhe prej 1,2 milion denarë (19 mijë euro) i është paguar KB "Çair 2030", ndërsa prej organizatave nga veprimtaritë tjera, shuma më e madhe i është ndarë Shoqatës "Muza" Shkup dhe Shoqatës për informim transparent "Oti Grup", nga 100 mijë denarë (1,626 euro).

Identike është shuma prej dy milionë denarë (32,5 mijë euro) që Komuna e Çairit ka paraparë t'ua transferojë organizatave joqeveritare edhe në vitin 2023. Të njëjta janë edhe shumat të cilat janë paraparë sipas zërave konkretë edhe atë 1,3 milion denarë (21 mijë euro) për organizatat joqeveritare, 300 mijë denarë (rreth 5 mijë euro) për klubet sportive dhe nga 200 mijë denarë (3,250 euro) për organizatat humanitare dhe transfere tjera.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna e Çairit në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	1,300,000	0%
463120 Transferet për klubet sportive	300,000	0%
463160 Transferet për organizatat humanitare	200,000	0%
463190 Transfere tjera për organizatat joqeveritare	200,000	0%
Gjithsej në denarë	2,000,000	0%
Gjithsej në euro	32,520	0%

KOMUNA SH TIP

Komuna Shtip e ka paguar thuajse tërësisht shumën e paraparë në zërin buxhetor 463 për vitin 2022. Shuma më e lartë i është paguar KF "Bregallnica" në vlerë prej 9 milionë denarë (146 mijë euro). Nga sferat tjera, shumën më të lartë është paguar për Shoqatën humanitare "Podaj raka, spasi zhivot" për projektin Rojtarë të mjedisit jetësor në vlerë prej 299,955 denarë (4,877 euro).

Mjete të paguara nga zëri buxhetor 463 i Komunës Shtip në vitin 2022

Llogaria	Mjete të paguara për vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	1,439,500
463120 Transferet për klubet sportive	13,845,000
Gjithsej në denarë	15,284,500
Gjithsej në euro	248,528

Komuna Shtip ka shpallur dy thirrje publike, edhe atë nga Programi për mundësi të barabarta dhe për fushat e ekonomisë dhe turizmit, infrastrukturës, arsimit, kulturës, sportit dhe mjedisit jetësor. Thirrjet kanë qenë të shpallura në ueb-faqen e komunës, mirëpo më vonë i kanë larguar nga ueb-faqja.

Thirrjet përmbajnë të dhëna për fushat e përgjithshme prioritare (ekonomi dhe turizëm; infrastrukturë; arsim, kulturë, sporti dhe mjedisi jetësor), kriteret për pjesëmarrje, buxheti total i paraparë, por nuk përmbajnë synime prioritare të cilat pritet të përmbushen, ndërsa kriteret për përzgjedhje janë të rregulluar me Metodologjinë për ndarje të mbështetjes financiare nga buxheti i komunës Shtip për projektet e shoqatave dhe fondacioneve. Në pajtim me Metodologjinë, ekziston sistem vlerësimi në pajtim me të cilin kriteret për vlerësim i përfshijnë kapacitetin e organizatës, cilësinë e projektit dhe buxhetin.

Vendimet për përzgjedhjen e organizatave dhe projekteve që janë të mbështetura, janë dërguar në shtojcë të përgjigjes për kërkesën për qasje të lirë tek informacionet me karakter publik, por nuk janë publikuar në ueb-faqen e komunës. Gjithashtu, në ueb-faqen e komunës nuk janë publikuar dokumentet në të cilat jepet llogari për mjetet e shpenzuara nga ana e organizatave të përkrahura.

Komuna Shtip për vitin 2023 ka paraparë 15,75 milionë denarë (256 mijë euro) në zërin buxhetor 463 që është rritje minore në raport me vitin 2022.

Projektme të zërit buxhetor 463 nga Komuna Shtip në vitin 2023

Llogaria	Mjete të planifikuara për vitin 2023	Ndryshimi në raport me vitin 2022
463110 Transferet për shoqatat qytetare dhe fondacionet	2,150,000	+4.65%
463120 Transferet për klubet sportive	13,600,000	0%
Gjithsej në denarë	15,750,000	+0.6%
Gjithsej në euro	256,097	+0.6%

REKOMANDIME

- » Për shkakun që, madje 91% të mjeteve financiare nga zëri buxhetor 463 u ndahen klubeve sportive, ndërsa pjesa më e madhe e atyre mjeteve u transferohen klubeve që janë të regjistruar si shoqëri aksionare, nevojitet që pagesat ndaj atyre klubeve të bëhen nëpërmjet ndonjë zëri tjetër buxhetor ose zëri buxhetor - "Transferet për organizatat joqeveritare" të riemërtohet. Me praktikën e deritanishme krijohet përshtypje e gabuar që shoqatat qytetare fitojnë shumë të konsiderueshme nga komunat, që në realitet nuk është ashtu.
- » Për ndërtimin e një shoqërie qytetare të fortë dhe të pavarur, me rëndësi thelbësore është që mbështetja të mundësohet në procedurë transparente dhe të mos lihet hapësirë për favorizimin e aktiviteteve të cilat në vend të interesit publik i mbrojnë interesat partiake të autoriteteve lokale.
- » Thirrjet për ndarje të mjeteve financiare për shoqatat qytetare duhet të jenë në lidhje me programe konkrete të komunave dhe të udhëzojnë në synime qartë të përcaktuara si dhe të kontribuojnë në drejtim të realizimit të atyre synimeve. Në atë drejtim do të ishte e dobishme të përkufizohen synimet e financimit buxhetor nga zëri buxhetor 463 dhe t'i jepet përparësi financimit të projekteve për realizimin e atyre synimeve, përkundër financimit të organizatave si të tilla.
- » Të insistohet për përfshirje më të madhe të organizatave joqeveritare dhe të qytetarëve në procesin e përcaktimit të programeve të komunave, përkatësisht të fushave prioritare të cilat janë në interes më të gjerë të qytetarëve.
- » Nevojitet të unifikohet qasja e shpërndarjes së mjeteve nga njësitë e vetëqeverisjes lokale dhe përforcim i transparencës dhe llogaridhënies në planifikimin dhe realizimin e mjeteve të parapara për financim të shoqatave qytetare. Në këtë mënyrë do të sigurohet edhe objektivitet më i madh në procesin e ndarjes së mjeteve dhe do të reduktohen rreziqet nga keqpërdorimet e fondeve dhe shpërndarja pa dedikim e mjeteve.
- » Të gjitha thirrjet për shpërndarje të mjeteve nga buxhetet e komunave duhet t'i përmbajnë elementet në vijim: përshkrim i programit; lloji i projekteve të cilat do të financohen; synimet të cilat duhet të përmbushen; grupet e synimit për mbështetjen; kriteret themelore për shpërndarjen e mjeteve; kriteret që shoqatat qytetare duhet t'i plotësojnë dhe fondacionet të cilat mund të paraqiten në thirrjen; korniza kohore për zbatimin e projekteve që do të përzgjedhen; shuma totale e mjeteve të parapara/në dispozicion; shuma e mjeteve që do të jenë në dispozicion për çdo projekt veçmas; dokumentacioni i cili kërkohet për t'u parashtruar; metodologjia e vlerësimit të projekteve; dokumentacioni që duhet të parashtrohet; afati kur do të publikohen rezultatet si dhe elemente tjera. Në këtë mënyrë do të shmanget rreziku nga favorizimi i organizatave dhe aktiviteteve të caktuara të shoqërisë qytetare përkundër anashkalimit të organizatave dhe aktiviteteve tjera.

- » Nevojitet promovim më i madh i thirrjeve për shpërndarje të mjeteve me qëllim që numër më i madh i organizatave të jenë të njoftuara për mundësinë për të aplikuar.
- » Medoemos të publikohen emrat e organizatave që kanë fituar mjete financiare, dedikimi i mjeteve të shpërndara, shuma e tyre, si dhe raportet për aktivitete të realizuara. Në këtë mënyrë, gjithë publiku do të ketë këqyrje në arsyetimin e mjeteve të ndara dhe mënyrën si ato janë shfrytëzuar.
- » Organizatat që kanë fituar mjete financiare nga zëri buxhetor 463 do të jenë të detyruara të parashtrojnë raport për gjithçka që kanë realizuar dhe ta publikojnë atë në ueb-faqet e komunave
- » Pa detyrimin për raportim dhe pa shpalljen publike të raporteve, zvogëlohet besimi në organizatat qytetare dhe reduktohet dukshmëria e tyre.
- » Të insistohet për rritje të ndihmës financiare për shoqatat qytetare dhe fondacionet për shkak se, me mbështetjen e vogël financiare, shoqatave qytetare u pamundësohet ta ushtrojnë rolin e tyre shoqëror dhe të ndihmojnë në avancimin e punës së institucioneve lokale.
- » Ndonëse mbështetja nga buxhetet e komunave për sportin është e madhe, megjithatë nevojitet të reflektohet mbi qasjen aktuale sipas të cilës, sportet rekreative, zhvillimi i sportit në kategoritë e reja, manifestimet sportive dhe ngjashëm vihen nën hijen e klubeve profesionale sportive.

